



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:273363
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05565359

C-IV-14-6208

Parashtruesja e kërkesës

H A S nga Prishtina.
kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “Marketing - Export” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 12 prill 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit aprovohet si pjesërisht e bazuar.**
- 2. Shfuqizohet Aktvendimi i Autoritetit të likuidimit PRN096-0010 datë 26 gusht 2014.**
- 3. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankueses, H A S në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 343.80 Euro.**
- 4. Pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 12,106.12 Euro refuzohet si e pabazuar.**
- 5. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 24 shtator 2014, ankuesja pranë DHPGJS, parashtron kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN096-0010 datë 26 gusht 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 12,449.92 (një dy katër katër nëntë dy) Euro, ndaj NSH “Marketing - Export” (në likuidim).

Ankuesja pohon se pranë NSH ishte e punësuar nga data 1 korrik 1980 e gjer 19 janar 2012, kur si rezultat i shitjes – privatizimit të aseteve të NSH i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Ankuesja tutje pohoj se ishte përfituese e pjesës së shumës së 20% nga privatizimi i NSH, e cila e drejtë i ka takuar si e punësuar pranë NSH dhe e drejtë kjo e fituar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (e plotësuar dhe ndryshuar).

Ankuesja gjithashtu pohon se nuk kanë pasur qasje në objektin e NSH për shkak se është shfrytëzuar nga Organizata Botërore e Ushqimi (World Food Program). Ankuesja thekson se gjatë kësaj periudhe kanë pranuar paga në vlera të ndryshme duke filluar nga 40 Euro e gjerë 150 Marka Gjermane.

Nga gjitha arsyet i propozon gjykatës që kërkesa e saj të aprovohet dhe kërkon që në emër të pagave të papaguara, për periudhën nga muaji prill 2003 e gjer me 19 janar 2012 ti paguhet shuma e kërkuar prej 12,449.92 (një dy katër katër nëntë dy) Euro.

Kërkesës për rishikim – ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e Njoftimit drejtuar ankueses nga ana e AKP, me të cilën ankuesja është informuar mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nga data 18 prill 2011 (në tekstin në vijim NJOFTIMI),
- Kopja e Vërtetimit mbi përvojën e punës së ankueses, datë 28 janar 2014, lëshuar nga AKP,
- Kopja e Vendimit nr. 3889 datë 8 tetor 1980, lëshuar nga NSH mbi caktimin në punë dhe detyra të praktikantes,
- Kopja e listës përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë përfituar pjesën e të hyrave të 20% nga privatizimi i NSH, listë kjo e publikuar nga ana e AKP, ankuesja ishte përfituese e këtyre të hyrave. Në këtë listë gjithashtu figuron përvoja e punës së ankueses dhe atë 20 vite e 3 muaj (në tekstin në vijim LISTA E PUNËTORËVE), dhe
- Lista e pagave –akontacionit për punëtorët e NSH, për muajin tetor 1999, dhjetor 1999, dhjetor 2000, janar 2000, nëntor 2001, dhjetor 2001, janar 2001, prill 2002, janar 2003, shkurt 2003. Sipas kësaj liste ankuesja ishte në listë, sipas numrit rendor 20, 27, 31 respektivisht 33 (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE –AKONTACIONIT).

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 10 nëntor 2022 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankueses ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesja nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së saj, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankueses konsiderohet e pabazuar respektivisht parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për AKP. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e ankueses të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur

- Kopja e Vendimit të AL.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesja me 5 dhjetor 2022 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesja mbeti në tërësi si pranë kërkesës së saj për rishikim-ankesës dhe propozoj që kërkesa e saj të aprovohet.

Gjykata gjithashtu gjeti se ankueses, sipas listës përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë përfituar pjesën e të hyrave të 20% nga privatizimi i NSH, listë kjo e publikuar nga ana e AKP, ishte përfituese e këtyre të hyrave.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për rishikim aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Kërkesa për rishikim-ankesa është parashtruar kundër Vendimit të AL, me të cilin objekt shqyrtimi ishte kërkesa e ankueses pagash për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës, e cila parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP. Ankuesja me kërkesën e saj për rishikim-ankesë, atakoj Vendimi i cekur si më lartë të AL, gjersa kërkoj kompensim pagash të pa-paguara kërkesë kjo e cila nuk ishte parashtruar dhe nuk ishte objekt shqyrtimi pranë AL, si kategori e veçantë e kërkesave sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Bazuar në nenin 74 të Ligjit për DHPGJS “*Shqyrtimi i vendimeve të Autoritetit për likuidim*” procedura para DHPGJS zhvillohet për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose aseti sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare.

Bazuar në dispozitën e cekur si më lartë dhe kërkesën e ankuesit pranë AL, konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast ankuesja ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ka qenë punëtore e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

NJOFTIMI dhe LISTA E PUNËRËVE dhe LISTA E PAGAVE -ANKONTACIONIT, argumentojnë faktin se e njëja ishte punëtore aktive i NSH-së gjer me datën, 18 prill 2011.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankueses, respektivisht nuk

e ka argumentuar të kundërtën me çka ankueses do ti mohohet e drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Gjykata gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, si dhe nga përvoja e dëshmuar nga LISTA E PUNËTORËVE e publikuar nga AKP, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankueses, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi).

Në interpretim të dispozitës së cekur si më lartë, gjykata me rastin e vendosjes së shumës së kërkuar, veproj sipas LISTËS PAGAVE – AKONTACIONIT.

Paga e ankueses për vitet 1999 gjer 2001 ishin të kompensuara sipas valutë Gjermane – Marka Gjermane. Për këtë periudhë, sipas listave, shihet se ankuesja për shtatë (7) muajt e viteve 1999, 2000 dhe 2001 ka pranuar gjithsejtë 950.00 Marka Gjermane. Shumën prej 950.00 e përpjesëtoj për 7 (shtatë) e që në total i bie që të ardhurat mesatare mujore të ankueses të jetë shuma prej 135.70 Marka Gjermane. Tutje këtë shumë nga Marka Gjermane e konvertoj në EURO, ashtu që shuma e pagës për ankuesen në Euro, për vitet 1999 gjer 2001, të jetë shuma prej 65.85 Euro.

Sa i përket viteve 2002 dhe 2003, sipas listave, shihet shuma totale e pranuar nga ankuesja prej 195 euro. Këtë shumë, po ashtu sipas listave, e përpjesëtoj për 4 muaj, i bie që paga mesatare e ankueses të jetë shuma prej 48.75 Euro.

Përfundimisht gjykata mori shumën totale të pagave për vitet 1999 gjer 2001, e që është shuma prej 61.85 Euro dhe për vitet 2002 gjer 2003 48.75 mbledhë shumën totale e që bie shuma prej 11.60 dhe përpjesëtoj për këto dy periudha dhe shuma mesatare e pagave i bie të jetë shuma prej 57.30 (pesë shtatë tre) Euro.

Kjo shumë, 57.30, është shumëzuar për gjashtë (6) paga, e që përbën shumën e tërësishme prej 343.80 (tre katër tre tetë zero) Euro ($57.3 \times 6 = 343.8$).

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesja ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Pjesa e mbetur, prej 12,106.12 (një dy një zero gjashtë një dy) Euro, gjykata e refuzon për arsye se paga e ankueses, siç edhe u cek si më lartë u vërtetua nga LISTA E PAGAVE - AKONTACIONIT.

Çështja e parashkrimit të kërkesave të ankueses

NJOFTIMI dhe LISTA E PUNËTORËVE e, argumentojnë faktin se ankuesja ishte punëtore aktive e NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, 18 prill 2011.

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Më tutje sipas nenit 370, të po të njëjtit ligj, thuhet:

“Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitat e lartë cekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Rregullat për parashkrimin në rastin konkret nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankueses, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventuale, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartëcekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditorë, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (lex specialis).

Asnjë punëtor/e apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditorë ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesja nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Ankuesja ka paguar taksat gjyqësore.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar